



---

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA SUHAREKË  
OPSTINA SUVA REKA / MUNICIPALITY OF SUHAREKE  
ZYRA E PROKURIMIT  
PROCUREMENT OFFICE

Nr: 008/2022  
Nr. Protokoli: 19/2022  
Date: 08.04.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës **06.04.2022**, të parashtruar nga Operoret Ekonomik: **Grup i Operatorëve Ekonomik TECH VISION SH.P.K.; Mehmet Sahitolli B.I.; Nita Macula B.I., Prishtinë, Rruga Bardhyl Çausi, Kompleksi Royal, Hyrja C15/16, kati 2, nr. 9, -10000, PRISHTINË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative** me Nr. të Prokurimi: **624-22-2257-5-5-8 & 624-22 031 121** nxjerr këtë:

#### V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës **06.04.2021**, e parashtruar nga Operoret Ekonomik: **Grup i Operatorëve Ekonomik TECH VISION SH.P.K.; Mehmet Sahitolli B.I.; Nita Macula B.I., Prishtinë, Rruga Bardhyl Çausi, Kompleksi Royal, Hyrja C15/16, kati 2, nr. 9, -10000, PRISHTINË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative** me Nr. të Prokurimi: **624-22-2257-5-5-8 & 624- 22 031 121**, kundër Njoftim për Vendimin e AK -së, të datës **01.04.2002** të publikuar në platformen elektronike.
  2. **Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 01.04.2022.**
  3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
  4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
-

## Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë: **01.04.2022**, ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit: **Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative** me Nr. të Prokurimi: **624-22-2257-5-5-8 & 624- 22 031 121**, kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të dates, 01.04.2022, të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se pretendimet tuaja nuk qëndrojnë sepse:

-AK duke pas për bazë shfrytëzimin e fondeve ka respektuar nenin 1 të LPP-së (Qëllimi) sepse ne kemi propozuar për kontratë OE të përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

-Po ashtu janë respektuar nenet 6 dhe 7 të LPP-së sepse ju jeni trajtuar i barabartë në këtë procedurë, për më tepër kjo është një procedurë me MINITENDER ku të gjithë OE të cilët janë ftuar të dorëzojnë tenderët janë të kualifikuar nga AQP.

-Sa i përket kërkesave të ftesës për ofertim, OE i propozuar ka prezentuar dhe ka plotësuar kërkesat konform pikës IV.6) Formulari i Tenderit dhe numri i ekzemplareve të Tenderit dhe Lista e Dokumenteve të kërkuara., përfshirë katalogun e kërkuar, deklaratën për specifikimet teknike dhe deklaratën për garancionin e produkteve.

-Specifikat teknike të pajisjeve të kërkuara janë pjesë e marëveshjes kornize të nënshkruar në mes të AQP dhe të gjithë ju si OE, e po ashtu edhe OE të propozuar për kontratë dhe AK ka kërkuar nga OE që të plotësojnë deklaratën për specifika teknike, për qka OE i propozuar ka dorëzuar deklarata dhe mbetet që OE i propozuar gjatë realizimit të kontratës ti përbahet në përpikshmëri këtyre specifikave të kërkuara. Kërkesa për këtë qështje nga ana e juaj si OE ankues nuk ka kuptim sepse ju tashmë të gjithë jeni të kualifikuar dhe është e përcaktuar në marëveshjen kornizë edhe specifikimet teknike të detyrueshme. Specifikat janë vendosur në ftesën për ofertim të njëjta për të gjithë OE dhe për këtë është kërkuar deklarata për përmbushjen e tyre. Pra edhe në këtë qështje AK ka vlerësuar konform nenit 59 të LPP-së duke propozuar për kontratë OE i cili nga të gjitha ofertat përveq që ka plotësuar dëshmitë e kërkuara ka patur çmimin më të lirë.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Shef i Zyres së Prokurimit  
Bujar Kuçi

